# DËSHMI ARKIVI

**A-452370**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Superkupa e Spanjës 2027 në Stamboll: Zyrtarizohen datat, përballjet, stadiumi dhe shpërblimet |
| ADRESA | `https://albeu.com/sport/superkupa-e-spanjes-2027-ne-stamboll-zyrtarizohen-datat-perballjet-stadiumi-dhe-shperblimet/1016124/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 13:13:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 13:08:38 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `677414d751642c18632823baab20e7e258d7c20e175449d1983d91800f0c8176` |
| TEKSTI | `7c31067cea803c34ac4cf69973c95b4a7b110a794c8cc26df06e4bfbf88ee637` |
| PAMJA | `0162d014ee4afd88cab71d4ad2131862a58a8e774febeb5b56ac62475bbfda81` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1f22b2c4e582569143d992ab5451124c607517a534bbdb7e5e1199b0504243af` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1f22b2c4e582569143d992ab5451124c607517a534bbdb7e5e1199b0504243af`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Superkupa e Spanjës 2027 në Stamboll: Zyrtarizohen datat, përballjet, stadiumi dhe shpërblimet




Edicioni i vitit 2027 i Superkupës së Spanjës do të organizohet në Stamboll të Turqisë, ku katër prej klubeve më të mëdha të futbollit spanjoll do të garojnë për trofeun.

Kompeticioni është parashikuar të luhet në fillim të shkurtit 2027. Pjesë e tij do të jetë sërish Barcelona, fituese e dy edicioneve të fundit.

Federata Mbretërore Spanjolle e Futbollit (RFEF) e ka konfirmuar zyrtarisht Stambollin si qytetin pritës, ndërsa të gjitha ndeshjet do të luhen në stadiumin olimpik "Ataturk".

Në ceremoninë zyrtare për prezantimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes në Stamboll pritet të jetë i pranishëm presidenti i RFEF-së, Rafael Louzan. Atij do t'i bashkohen përfaqësues të lartë të institucioneve turke dhe ndërkombëtare.

Zgjedhja e qytetit turk u bë për shkak se Arabia Saudite, e cila zakonisht e ka pritur Superkupën, në atë periudhë do të jetë e angazhuar me një tjetër aktivitet të madh sportiv. Vendimi erdhi pas një procesi vlerësimi të kryer në bashkëpunim me kompaninë SELA, partneren e RFEF-së për organizimin e turneut jashtë territorit spanjoll.

Barcelona, Real Madridi, Real Sociedad dhe Atletico Madridi janë katër skuadrat që do të marrin pjesë në edicionin e vitit 2027.

Më 2 shkurt do të zhvillohet gjysmëfinalja e parë, në të cilën Real Sociedadi do të përballet me Real Madridin. Po në të njëjtën ditë, Barcelona do të luajë kundër Atletico Madridit.

Ndeshja finale është caktuar për 7 shkurt, kur fituesit e dy gjysmëfinaleve do të përballen për trofeun.

të fundit/


Dyshohet se u godit nga rryma, humb jetën 35-vjeçari në...


Pas 81 viteve burg në shkallën e parë, vendimi për katërshe...


Bashkëshortja e Rexhep Selimit reagon me mesazh të fortë nj...


Superkupa e Spanjës 2027 në Stamboll: Zyrtarizohen datat,...


Mbappe synon ta rikthejë Topin e Artë në Madrid dhe vlerëson...


Nga traktorët te supermakinat, rrugëtimi i logos së famshme t...


Carney përshëndet synimin e BE-së për forcimin e aleancës...

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Krahas mundësisë për të fituar titullin, turneu u garanton pjesëmarrësve edhe të ardhura të konsiderueshme. Sipas marrëveshjes së raportuar nga AS, katër klubet kanë pranuar që shumën prej 40 milionë eurosh ta ndajnë në pjesë të barabarta.

RFEF ka nënvizuar se zhvillimi i Superkupës jashtë Spanjës krijon të ardhura që përdoren më pas për të mbështetur qindra klube të niveleve më të ulëta të futbollit spanjoll, si në garat e meshkujve, ashtu edhe në ato të femrave.

Takimet e Superkupës së Spanjës pritet të transmetohen në mbi 150 vende të botës, duke i dhënë turneut përmasa të rëndësishme ndërkombëtare për futbollin spanjoll.

Shtuar më 17.09.2026 15:08

Tags: Atletico Madrid , BARCELONA , real madrid , real sociedad , Superkupa e spanjës


Mbappe synon ta rikthejë Topin e Artë në Madrid dhe vlerëson rivalin Yamal


Franco Foda reagon pas tërheqjes së Amir Rrahmanit nga Kombëtar…


Ramos nën presion te Milani, shifrat shqetësuese pas transferimit rekord


Espi dhe Guler kërkojnë më shumë hapësirë te Reali me paraqitjet e tyre


Irlanda shpall skuadrën për duelin me Kosovën, në listë edhe i biri i Rudi Vatës



Kukësi reagon pas disfatës dhe zyrtarizon ish-sulmuesin e Superiores


Para duelit me Teutën, Emiljano Musta zbulon arsyen e largimit nga…


Liverpooli piketon ish-talentin e Bayern Munichut si alternativë për Wirtz

albeu © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.